



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dërguar / Priljen / Predato Received / Delivered	21. 11. 2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM SHK	7051	2023	1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1252/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1252/2023 të datës 05.10.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ më adresë: _____ kundër organit të punësimit/Shërbimit Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 20.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1252/2023 e datës 05.10.2023 e parashtruar nga ankuesi _____

II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke bërë kompensimin e pagës me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes së ankues në pajtim me Vendimi me Nr.057 të datës 17.10.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, sipas kërkesës për pagesë retroaktive të datës 07.02.2023.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar sipas Kontratës së Punës për kohë të pacaktuar të datës 12.06.2018 në pozitën "Oficer Korrektues" në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 29.12.2022 ka parashtruar kërkesë për kompensimin e një page me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes nënës, ndërsa sipas Vendimit me Nr. 057 të datës 17.01.2023

të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës të njëjtit i është lejuar pagesa e një page shtesë me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, kurse me Shërbimi Korrektues i Kosovës më datë 07.02.2023 ka proceduar në Thesarin e Kosovës formularin për pagesën e një page me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes për ankuesin, mirëpo ankuesit nuk realizuar kompensimi material.

Ankuesin lidhur me moszbatimin e Vendimit me Nr.057 të datës 17.01.2023 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, më datë 04.10.2023 përmes postës ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 05.10.2023 dhe është regjistruar nën shenjen A.nr.1252/2023 me numër protokolli 6400/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 11.10.2023, tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 11.10.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6400/2023 të datës 05.10.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 18.09.2023 nga për Kërkesën për pagesë retroaktive e datës 07.02.2023; Ankesën e datës 06.09.2023; Vendimin me Nr. 057 të datës 17.01.2023; Zarin e datës 04.10.2023 me numër R5568550; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 11.10.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 11.10.2023; Kontratë punë për kohë të pacaktuar e datës 12.06.2018; Dokument identifikues i ankuesit; Kërkesën e datës 29.12.2023; Çertifikatë e vdekjes e datës 27.12.2022 me shifër serik: V10557722; Ekstrakt nga regjistri qendror i gjendjes civile e datës 29.12.2022; Deklaratën për bashkësinë familjare e datës 27.12.2022; Deklaratën nën betim e noterizuar me shifër LRP.nr.10337/2023; Kërkesën e datës 08.11.2023 drejtuar për zyrtarin e Thesarit të Kosovës nga E-mailin e datës 07.02.2023 nga për dhe Shkresën për pagesat e pagave me ndryshim për muajin shkurt 2023 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës për zv. Udhëheqësin e Divizionit të Sistemit të Pagesave në Ministrinë e Financave; Konfirmimin për disponueshmërinë e mjeteve buxhetore e datës 01.02.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave materiale të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar më datë 05.10.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk është zbatuar Vendimi me Nr. 057 i datës 17.01.2023 i zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, më kërkesën që Këshilli të obligoi organin komentet për zbatimin e Vendimit me Nr.057 i datës 17.01.2023.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas Çertifikatës së vdekjes me Nr. serik V 10557722 të datës 27.12.2022, konstatohet se i ndjeri gjegjësisht i ati i ankuesit ka ndërruar jetë me datë 13.12.2022, ndërsa ankuesi sipas legjislacionit në fuqi kërkesën për kompensim të një page me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes e ka parashtruar kërkesë më datë 29.12.2022, kurse Drejtorit i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës me datë 17.01.2023 ka nxjerr Vendimin me shifër Nr.057 për lejimin e pagesës shtesë, sikurse përcaktohej me dispozitat që kanë qenë në fuqi asaj kohe, gjegjësisht Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve

Civil dhe aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji lidhur me kompensimet tjera, respektivisht Rregullorja Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, ku nëpunësve civil u njihet e drejta e kompensimit të një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil për ankuesin me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes.

Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore të aplikueshme në kohën e vdekjes së të atit të ankuesit, përkatësisht dispozitave të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil ku me nenin 22 paragrafi 2 përcaktohet se: *2. Nëpunësit civilë, kanë të drejtat në vijim; ..2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësi civil; si dhe dispozitave të nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, ku parashihej se: ...2. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, në rast të vdekjes së një anëtari të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil” dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstaton se me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, nëpunësi civil sipas dispozitave të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil gëzonte të drejtën e ndihmës institucionale, përmes realizimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.*

Me qëllim të shqyrtimit të lëndës, Kolegji i Këshillit iu referua Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, përkatësisht nenit 271 ku përcaktohet se: *Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji”.* Po ashtu, lidhur me këtë fakt, Kolegji i Këshillit thekson faktin se Gjykata e Apelit të Kosovës, sipas Aktgjykimit A.A.nr.14/2017, ka përcaktuar përkufizimi i familjes duke iu referuar dispozitave si më lartë të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes.

Nisur nga përcaktimi ligjor si me sipër, si dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Çertifikatës së Vdekjes me Nr. serik V 10557722 të datës 27.12.2022, konstatohet se i ndjeri gjegjësisht i ati i ankuesit ka ndërruar jetë me datë 13.12.2022 kurse adresa e tij e fundit ka qenë Rruga kurse sipas Ekstraktit nga regjistri qendror i gjendjes civile i datës 29.12.2022 dhe Deklaratës nën betim të noterizuar me shifër LRP.nr.10337/2023 konstatohet fakti se edhe ankuesi ka jetuar në të njëjtën adresë bashkërisht, respektivisht Rruga kështu që duke iu referuar nenit 22 paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil dhe nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, Kolegji i Këshillit vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, për rastin e vdekjes së të atit është i bazuar, pasi që Vendimi me Nr.057 i datës 17.01.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës është nxjerrë në kohën sa kanë qenë në fuqi dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Meqenëse Shërbimi Korrektues i Kosovës, respektivisht zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës përmes Vendimit me Nr.057 të datës 17.01.2023 i ka lejuar kompensimin shtesë për rastin e vdekjes së anëtarit të familjes dhe duke marr parasysh faktin që

kërkesa për pagesë retroaktive e datës 07.02.2023 është dërguar për ekzekutim në Thesarin e Kosovës, atëherë Kolegji i Këshillit në kuptim të respektimit të normave ligjore të cekura si më lartë konstaton se Shërbimi Korrektues i Kosovës ka përmbushur obligimin ndaj ankuesit, ngase Shërbimi Korrektues i Kosovës përmes shkresave të lëndës me datë 07.02.2023 rastin e kompensimit të ankuesit e ka përcjellë tek z. _____ për pagesë të pagave me ndryshime për muajin shkurt 2023, ndërsa përmes e-mailit të njëjtën shkresë e ka përcjellë tek znj. _____ dhe z. _____ ndërsa tani çështja e ekzekutimit të Vendimit Nr.057 të datës 17.01.2023 për pagesë me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes të ankuesit bie në barrë të Thesari të Kosovës, kështu që sipas këtij vendimi obligohet Drejtori i Thesarit të Kosovës që sipas Vendimit me Nr.057 të datës 17.10.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe kërkesës për pagesë retroaktive të datës 07.02.2023 duke u mbështetur edhe në legjislacionin e aplikueshëm në kohë, të bëjë zbatimin e këtij vendimi sikurse u vendos në dispozitivin e këtij vendimi.

Meqenëse Shërbimi Korrektues i Kosovës, respektivisht zëvendësuesi i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës përmes Vendimit me Nr.058 të datës 17.01.2023 i ka lejuar kompensimin shtesë për rastin e vdekjes së anëtarit të familjes dhe duke marr parasysh faktin që kërkesa për pagesë retroaktive e datës 07.02.2023 është dërguar për ekzekutim në Thesarin e Kosovës, atëherë Kolegji i Këshillit në kuptim të respektimit të normave ligjore të cekura si më lartë konstaton se Shërbimi Korrektues i Kosovës ka përmbushur obligimin ndaj ankuesit, ndërsa tani çështja e kompensimit të pagesë me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes për ankuesin bie në barrë të Thesari të Kosovës, kështu që sipas këtij vendimi obligohet Drejtori i Thesarit të Kosovës që në kuptim të Vendimit me Nr. 058 të datës 17.10.2023 të zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, kërkesës për pagesë retroaktive të datës 07.02.2023 dhe legjislacionit të aplikueshëm në kohë, të bëjë zbatimin e këtij vendimi si në dispozitiv të tij.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1252/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit*
- *Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës;*
- *Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;*
- *Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK- së.*

